



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
SANKSIONEVE

Data: 11 Maj 2021

Nr: 74

VENDIM

PËR KTHIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 50, PARAQITUR NË KQZ NË DATËN
10.05.2021 PËR PLOTËSIMIN E ELEMENTEVE TË FORMËS, TË PËRCAKTUARA NË
NENIN 126 TË KODIT ZGJEDHOR

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 11.05.2021, me pjesëmarrjen e:

Elvis ÇEFA	-	Relator
Elvin LAKO	-	Anëtar
Illirjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Subjekti zgjedhor Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni
- Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK);

OBJEKTI: Shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 50 të subjektit zgjedhor Koalicioni
Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe
Konservatorët (ABEOK) me objekt “Shpalljen e pavlefshme të
zgjedhjeve në të gjitha QV”.

BAZA LIGJORE: Nenet 21, 124, 126, 129, 130 dhe 131 të “Kodi Zgjedhor i Republikës
së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 17 dhe 18 të vendimit të
Komisionit Rregullator nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e
funktionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve
dhe Sanksioneve”.



Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesit të koalicionit ABEOK,

V Ë R E N:

Subjekti zgjedhor Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK), ka depozituar pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 50 regj, datë 10.05.2021.

Në mbledhjen e datës 11.05.2021, ora 12:20, pas relativitetit të z. Elvis Çefa dhe diskutimit të përfaqësuesit të koalicionit ABEOK z. Kostaq Papa, KAS konstatoi se kërkesa ankimore nr. 50 është paraqitur me të meta dhe nuk i plotëson të gjithë elementët e formës të parashikuara në nenin 126 të Kodit Zgjedhor. Konkretisht:

Së pari: Në ankim nuk është referuar vendimi/vendimet që ankimohet, sipas parashikimit të nenit 126, pika 1, shkronja “b” të Kodit Zgjedhor;

Së dyti: ankuesi nuk ka depozituar së bashku me ankimin edhe vendimin e plotë, ndaj të cilit ushtron ankimin sipas parashikimit të nenit 126, pika 1 shkronja “dh” të Kodit Zgjedhor;

Së treti: ankimi i paraqitur në KAS nuk është shoqëruar me asnjë provë dhe nuk tregon asnjë provë që kërkohet të merret gjatë procesit të shqyrtimit të ankimit, në funksion të zgjidhjes së çështjes, sic parashikohet në nenin 126, pika 1, shkronja “e” të Kodit Zgjedhor.

Së katërti: subjekti ankues ka paqartësi dhe kontradikta në kërkesat e tij përfundimtare, kërkesa të cilat është e domosdoshme të riformulohen në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor.

Në bazë të nenit 129, pika 1, të K.Zgjedhor, KAS për çdo kërkesë ankimore të regjistruar bën verifikimin e ekzistencës së elementeve të formës sipas nenit 126 të K.Zgjedhor dhe të elementeve të përcaktuara në nenin 130 të po këtij kodi.

Në kushtet kur kërkesa ankimore objekt i kësaj procedure të plotësimit të formës dhe përmbajtjes nuk i plotëson kushtet e shkronjave “a” dhe “b” të pikës 1, të nenit 126, të K.Zgjedhor, ajo duhet t’i kthehet për plotësimin e elementeve të formës, sipas përcaktimeve të cituara si më sipër.



PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 126 dhe 129 pika 1 dhe pika 3 shkronja “c” të K.Zgjedhor dhe të nenit 17, pika 2, dhe pika 3, shkronja “c” të vendimit të Komisionit Rregullator nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” të Komisionit Rregullator, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

V E N D O S I:

1. Kthimin e kërkesës ankimore nr. 50, datë 10.05.2021, për plotësimin e elementeve të formës, të përcaktuara në nenin 126 të Kodit Zgjedhor të paraqitur nga subjekti zgjedhor Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

